

Statistikat e Pyjeve 2018

Korrik 2019

Tiranë, më 30 Korrik 2019: Në vitin 2018 fondi pyjor dhe kullosor i Shqipërisë shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.740.324 hektar (ha), duke zënë 60,54 % të sipërfaqes totale në vend.


Tab. 1 Bilanci Kadastral i Fondit Pyjor dhe Kullosor të Shqipërisë

Viti	Pyje		Kullota		Sipërfaqe me bimësi pyjore dhe inproduktive		Gjithsej	
	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%
2014	1.052.772	60,5	478.292	27,5	210.625	12,1	1.741.689	100
2015	1.052.253	60,4	478.188	27,5	210.456	12,1	1.740.897	100
2016	1.052.237	60,4	478.188	27,5	210.456	12,1	1.740.880	100
2017	1.051.871	60,4	478.081	27,5	210.387	12,1	1.740.339	100
2018	1.051.859	60,4	478.081	27,5	210.383	12,1	1.740.324	100

Në vitin 2018, pyjet shtrihen në një sipërfaqe prej 1.051.859 ha, që përfaqëson 60,4 % të fondit pyjor dhe kullosor. Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe prej 478.081 ose 27,5 % të fondit pyjor dhe kullosor. Sipërfaqet me bimësi pyjore dhe inproduktive që janë pjesë e fondit pyjor, zënë 210.383 ha ose 12,1 % të këtij fondi.


Në sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor në vitin 2018, si rezultat i dukurive natyrore dhe aktiviteteve njerëzore vihet re një rënie me rreth 16 ha, krahasuar me vitin 2017.

Fig. 1 Volumi i Përgjithshëm i Pyjeve (000/m³)



Në vitin 2018, volumi i përgjithshëm i pyjeve arrin në 54.878.000 m³, ku 94,0 % e këtij volumi përbëhet nga pyjet publike dhe 6,0 % nga pyjet private. Si pasojë e shfrytëzimeve dhe zjarreve, volumi është ulur afërsisht me 46,818 m³, krahasuar me vitin 2017.

Fig. 2 Fondi Pyjor Sipas Llojeve (ha)



Në vitin 2018, në fondin pyjor sipas llojeve, sipërfaqen më të madhe e zënë fletorët me 49,81 %, ndjekur nga shkurret me 35,84 % dhe halorët me 14,35 %.

Zonat e mbrojtura


Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë, janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë.

Tab. 2 Numri dhe Sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura

Kategoria e zonave të mbrojtura	Numër					Sipërfaqja (Ha)				
	2014	2015	2016	2017	2018	2014	2015	2016	2017	2018
Rezervë Strikte Natyrore	2	2	2	2	2	4.800	4.800	4.800	4.800	4.800
Park Kombëtar	15	15	15	15	14	210.501	210.501	210.501	210.501	230.707
Monument Natyror	750	750	750	750	750	3.470	3.470	3.470	3.470	3.470
Rezervë Natyrore e Menaxhuar	24	24	24	24	25	144.685	144.685	144.685	144.685	169.275
Peizazh i Mbrojtur	5	5	5	5	6	95.864	95.864	95.864	95.864	97.333
Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara	4	4	4	4	4	18.245	18.245	18.245	18.245	18.245
Gjithsej	800	800	800	800	801	477.566	477.566	477.566	477.566	523.831

Zonat e mbrojtura në vitin 2018, zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej 523.831 ha, ose 30,0 % të sipërfaqes së fondit pyjor dhe rreth 18,0 % të sipërfaqes së përgjithme të vendit. Gjatë vitit 2018 janë konstatuar ndryshime në numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura duke u rritur si në numër ashtu edhe në sipërfaqe.

Fig. 3 Sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura, Sipas Kategorive (%)



Në vitin 2018, sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zënë parqet kombëtare me 44,04 % të sipërfaqes gjithsej, ndjekur nga rezervat natyrore të menaxhuara me 32,31 %, peizazhet e mbrojtura me 18,58 %, zonat e mbrojtura të burimeve të menaxhuara me 3,48 %, rezervat strikte natyrore 0,92 % si dhe monumente natyrore me 0,66 %.

Metodologji

Publikimi i të dhënave mbi statistikat e pyjeve dhe biodiversiteti mbështetet në të dhënat administrative me baze vjetore. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucione të tjera përgjegjëse në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve.

Sipas VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike. Informacioni mblidhet në të gjitha Bashkitë e vendit të cilat kanë detyrimin ligjor të raportojnë çdo tre muaj në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave të pyjeve dhe biodiversitetit është Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Përkufizime

Kadastra e pyjeve: është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pellgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse.

Fond pyjor: janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtet), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.

Zonat e Mbrojtura: mund të kenë forma të ndryshme si, park kombëtar, zona të paprekura, zona të ruajtura nga komuniteti, rezervate natyrore dhe rezervate private natyrore. Sipas IUCN, "Një zonë e mbrojtur është një hapësirë gjeografike e mirë përcaktuar, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar përmes mënyrave ligjore ose metodave të tjera efektive, që sigurojnë mbrojtjen afatgjatë të natyrës dhe shërbimeve mjedisore të ekosistemeve që lidhen me të, si dhe vlerave kulturore."